

**V E N D I M**  
**Nr. 67 Date 20.06. 2008**

**PER**  
**FILLIMIN E PROCEDURAVE PER LICENSIMIN E SHOQERISE "BIOPOWER**  
**GREEN ENERGY " SH.P.K (PARK EOLIK BPGE1)**


Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pikat 1 germa a) dhe 8, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*", te ndryshuar, nenit 8 te "Rregullores per Procedurat e Licensimit" te miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.21 datë 04.04.2007, dhe neneve 18 pika 3, dhe 19 pika 3, te Rregullave te Praktikës dhe Procedurave te ERE-s", miratuar me Vendimin e Bordit te Komisionereve Nr.44, date 24.07.2007, në mbledhjen e tij të datës 20.06.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqeria "Biopower Green Energy" sh.p.k per tu licensuar ne aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit te centraleve elektrik si dhe prodhimit te energjise elektrike, (Park eolik BPGE1,

**Dhe konstatoi:**

- Paraqitjen, konform percaktimeve te Rregullores se Procedurave te Licensimit, te dokumentacionit dhe deklarave te kerkuara nga ERE kur dokumentacioni mungon,
- Me vendimin nr. 64 date 13/06/2008, Bordi vendosi te refuzoje licensimin e shoqerise ERS 08 sh.p.k, ne aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit te centraleve elektrik si dhe prodhimit te energjise elektrike, (Park eolik Lezhe, i cili perputhej me zonen e studiuar nga shoqeria Biopower Green Energy per Parkun BPGE1,



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I**  
**SEKTORIT TË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE**  
Bordi i Komisionereve



- Ligji nr. 9913 date 5.5.2008 ” Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” nuk mund te kete fuqi prapavepruese per aplikimet e paraqitura para hyrjes ne fuqi te ketij ligji.
- Eshte shuar kushti per pezullimin e procedurave te shqyrtimit te aplikimit të paraqitur nga shoqeria “Biopower Green Energy” sh.p.k, për liçensimin në aktivitetin e ndertimit, instalimit dhe shfrytezimit te centraleve elektrik si dhe prodhimit te energjise elektrike (Park eolik BPGE1),

Per sa konstatoi me siper Bordi i Komisionereve te ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të filloje procedurat per licensimin e shoqerise “Biopower Green Energy” sh.p.k ne aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit te centraleve elektrik si dhe prodhimin e energjise elektrike. (Park eolik BPGE1).
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut te njoftoje aplikuesin per vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s,

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s**

**Bujar Nepravishta**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I**  
**SEKTORIT TË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE**  
Bordi i Komisionereve

